

TË PAVARUR



DEMOKRACIA DHE POPULLI

RINESA (14), BRIKENA (14), ERONË P. (14), ERONA M. (14), ALBIN (14), BLEND (14), DIONIS (14),
LABINOT (14), BUTRINIT (14)



Një artikull i këndshëm që flet për demokracinë

Përshëndetje për të gjithë ju, lexues të kësaj gazete. Emri im është Demokraci. Unë jam një shtëpi e madhe dhe e lashtë. Ekzistoj që nga viti 507 p.e.s. kur u linda në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë. Unë i pranoj të gjithë qytetarët, ashtu siç janë. Pra, pa provuar t'i ndryshoj ata, apo mendimet e tyre. Të gjithë ata të cilët jetojnë brenda strehës sime, e dinë se janë të ba-

të gjithë këta qytetarë janë të barabartë dhe kanë të drejta të barabarta. Ata jetojnë në solidaritet, tolerancë, paqe, liri, e patjetër që edhe në barazi. Këto që i përmenda janë elementet e mia. Në bazë të këtyre elementeve unë identifikohem si Demokraci.

Megjithatë, edhe mua më nevojitet diçka për të mbijetuar. Ky është përkushtimi dhe puna e qytetarëve të mi. Nëse ata jetojnë në bazë të elementeve të mia dhe punojnë që unë të forcohem, unë jetoj dhe rritem. Këtë mund ta bëjnë duke respektuar të drejtat e njëri-tjetrit. Unë kam nevojë për qytetarët e mi, pasi që ata janë shtylla kryesore e ekzistencës sime. Ata vetë i zgjedhin udhëheqësit e vet me anë të votave. Duke e bërë këtë gjë, unë zhvillohem edhe më tej.

E shihni, pra, sa të rëndësishëm jeni për mua të gjithë ju qytetarët e shteteve demokratike? Punoni që unë të jem sa më e fortë dhe sa më e përmbushur me punën tuaj.



rabartë me njëri-tjetrin dhe gëzojnë shumë të drejta. Disa nga këto të drejta janë: e drejta e votës, e drejta e shkollimit, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e argëtimit, etj. E përmenda më parë barazinë. Për mua, barazia është elementi më i rëndësishëm që kam. A e dini pse? Sepse për mua, si Demokraci nuk ka rëndësi feja, raca, kombi, gjendja ekonomike, mosha, apo ndonjë karakteristikë tjetër.

Marrim shembull, në shtetet e mia jetojnë edhe persona me nevoja të veçanta, edhe persona të cilët nuk i takojnë as fesë së njëjtë, e as kombit të njëjtë. Mirëpo,



Gazetarët demokratë

Akoma nuk kemi përfunduar artikullin tonë. Në këtë pjesë të artikullit do të tregojmë më shumë fakte rreth demokracisë. Mësojeni cilat janë dy llojet e demokracisë



Jetojmë në paqe dhe liri

Përmes
këtij vizatimi kemi paraqitur
demokracinë. Paqja është një element
shumë i rëndësishëm në demokraci. E
pëllumbi është simbol i paqes. Kudo ku ka
demokraci në të gjithë botën, të gjithë
qytetarët janë të lumtur dhe jetojnë në
paqe me njëri-tjetrin

Demokracia
më bën të lumtur.
Demokracia më jep vlerë.
Demokracia më dhuron liri dhe
dashuri

Menduat se artikulli ynë përfundoi? Jo kaq shpejt. Qytetarë të dashur të cilët lexuat këtë artikull, ne nxënësit e grupit tonë iu falenderojmë. Megjithatë, ne kërkojmë nga ju që të punoni për të rritur demokracinë. E paraqitëm demokracinë si një shtëpi të madhe, që na pranon të gjithëve. Në këtë mënyrë menduam se do ta kuptoni rëndësinë që ka ajo në jetën tonë. Por, shpresojmë se keni kuptuar gjithashtu rëndësinë që ne kemi në demokraci. Ja edhe një fakt tjetër për demokracinë. Demokracia ka dy forma. Në demokracinë e drejtpërdrejtë qytetarët marrin vendimet direkt. Kurse, në demokracinë përfaqësuese qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e vet me anë të votave. Mirëupafshim lexues.



Jam e lirë të shpreh mendimet e mia

Paqja,
dashuria dhe lumturia
mbretërojnë në vendin tonë
demokratik



Demokracia është një botë e bukur me ngjyra dhe plot mrekulli

„SHTËPIA E LIGJEVE“

ALTIN (15), JETMIRA (14), DEA (14), BEQIR (14), MUSTAFË (14), HEROLINDA (14), DJELLONA (14),

ELVIRA (14)



Vendimi na takon neve, prandaj të mendohe mi mirë para se të veprojmë diçka



Arti i respekton ligjet. Gjatë vozitjes së veturës, ai vë rripin e sigurimit

Sa janë të rëndësishme ligjet? Si ndikojnë ato në jetën tonë? Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund t'i gjeni pikërisht në këtë artikull

Demokracia është mënyrë e qeverisjes, në të cilën udhëheq populli. Në vendet demokratike çdo person posedon shumë të drejta, që nga foshnja e posalindur e deri tek personi më i moshuar. Pra, në demokraci nuk ka dallim moshe, as feje, race apo gjinie.

Në jetën e përditshme ne kemi ligje dhe rregulla të cilat duhet t'i respektojmë. Për shembull: rregullat e komunikacionit, rregullat e shkollës, rregulloren e punës, etj. Në këto rregulla duhet t'i respektojmë me përgjegjësinë më të madhe. Ligjet neve na ndihmojnë të kemi një jetë më të sigurt, më të mirë dhe të jetojmë të lirë e në paqe.

Vendimet për këto ligje merren në Kuvend, si institucioni më i lartë legjislativ në vendin tonë. Në Kuvend punojnë deputetët, të cilët propozojnë ligje që duhet të jenë në të mirën tonë. Ky institucion i rëndësishëm ka tri funksione kryesore: funksionin legjislativ, atë përfaqësues dhe funksionin kontrollues. Përmes këtyre funksioneve, Kuvendi miraton ose nuk miraton ligjet, përfaqëson popullin dhe kontrollon punën e Qeverisë. Në Kuvendin e Kosovës punojnë gjithsej 120 deputetë, prej të cilëve 100 janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 prej tyre janë të komuniteteve jo shumicë. 10 nga ta janë serbë dhe 10 të tjerë janë turq, boshnjakë, romë, egjiptianë, ashkalinjë dhe goranë. Deputetët, të cilët punojnë në Kuvend zgjedhen me votat e popullit. Pra, vullneti i popullit është themeli i demokracisë.



Jemi një, jemi të barabartë



Bashkohuni me ne

VOTA SJELL NDRYSHIM

RIGON (14), DALINA (15), FJOLLA (14), FJONA (14), ELSA (15), ARTIN (15), GETUART (14), ASTRIT (14)



Zgjedhjet janë treguesi më i saktë i asaj se çka në të vërtetë dëshiron një popull. Këtë e dimë mirë nga historia e Kosovës, kur edhe janë mbajtur zgjedhjet gjatë kohës sa vendi ynë ishte nën sundimin ish-Jugosllav. Sesa ishin të rëndësishme ato zgjedhje, lexojeni artikullin në vijim

Demokracia do të thotë thjesht udhëheqje e popullit, për popullin, nga populli. Populli udhëheq përmes zgjedhjeve, duke votuar përfaqësuesit e vet. Në Kosovë të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin zgjedhor. Kur themi procesin zgjedhor, kuptojmë që përpos që votojnë, ata/ato kanë të drejtë edhe të kandidojnë. Gjithashtu, edhe të punojnë në mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve. Të gjithë ata qytetarë të cilët i takojnë moshës që e kemi cekur më lart, kanë pasur mundësinë që këtë vit të votojnë për dy lloje të zgjedhjeve. Zgjedhjet lokale të cilat u mbajtën në muajin tetor, në disa komuna të caktuara u mbajtën edhe në nëntor, për arsye se në këto komuna, kandidatët e partive kanë shkuar në balotazh.

Ky term përshkruan rastet kur numri i votuesve për kandidatët e partive politike është pothuajse i barabartë. Prandaj, dy partitë të cilat kanë fituar më së shumti vota, garojnë përsëri në mes vete. Në këtë rast, qyte-

tarët duhet të zgjedhin njëri apo tjetri parti. Kurse në muajin qershor, u mbajtën zgjedhjet qendrore apo parlamentare.

Kur jemi tek këto zgjedhje, donim t'iu tregojmë për zgjedhjet e para parlamentare të mbajtuara gjatë periudhës së sundimit ish-Jugosllav. Këto zgjedhje janë mbajtur me 24 maj të vitit 1992. Ani pse në atë kohë Kosova nuk ishte e pavarur, qytetarët kosovarë shënuan pjesëmarrje masive në këto zgjedhje. Ngjau kështu, sepse ata dëshironin që sa më shpejt vendi ynë të pavarësohej dhe të gjithë të jetonin të lirë. Zgjedhjet u mbajtën në kohën e okupimit serb në Kosovë, në rrethana të jashtëzakonshme. Por, patën rëndësi të madhe për demokracinë dhe shtet-ndërtimin e Kosovës. Qytetarët votuan sepse nuk dëshironin të ishin nën sundim dhe rëndësia e secilës votë ishte shumë e madhe. Qëllimi i çdo vote të dhënë ishte liria dhe përfaqësimi. Andaj qytetarë, tash që jemi të lirë, le të punojmë për të mirën e vendit tonë.



Në këto dy vizatime kemi paraqitur zgjedhjet qendrore dhe lokale. Parimisht, këto zgjedhje janë të njëjta sepse qytetarët dalin dhe votojnë për përfaqësuesit e tyre. Për këtë i kemi paraqitur si të njëjta. Ndryshimi mes tyre është se në zgjedhjet qendrore qytetarët i zgjedhin deputetët, ndërsa në zgjedhjet lokale ata votojnë për asamblistët dhe kryetarin e komunës



Qytetarët duke bashkëbiseduar për zgjedhjet



Ne e shkruajtëm këtë artikull me shumë dashuri për ju



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: IX-3
Vendi: Pozheran, Viti